



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 132 dt.22.09.1995

SUPRIMI I ZYRES SE ADRESAVE PRANE
GJENDJES CIVILE TE BASHKISE

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij dt.22.09.1995, pasi analizoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Z.Sali Kelmendi për suprimimin e Zyrës së Adresave të Gjendjes Civile të Bashkisë.

Vëren se :

Zyra ekzistuese e adresave që ndodhet në strukturën e Seksionit të Gjendjes Civile të Bashkisë, në kushtet e krijuara për lëvizjen e lirë të njerëzve ka humbur funksionimin e saj për evidentimin e adresave.

Funksionet e saj lypset të plotësohen në një spektër më të gjërë dhe për këtë do të ndërmerren studime të veçanta prandaj në kushtet e sotme mbështetur në nenin.17, të Ligjit Nr.7572, “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”Këshilli Bashkiak i Tiranës.

VENDOSI

1. Të suprimohet Zyra e Adresave e cila ndodhet në strukturën e aparatit të Bashkisë në administrimin e Seksionit të Gjendjes Civile.

2. Dokumentacioni i saj të kaloj në arshivën e Gjendjes Civile të Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Seksioni i Gjendjes Civile dhe Zyra e Administratës së Bashkisë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA